



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 30 shtator – 18 tetor 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Nyslim Murizi -	Zëvendëskryetar i Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Adriatik Alimadhi -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partive të Djathta
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Fatjona Dhimitri -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Ralf Gjoni -	Zëvendëskryetar i Komisionit për Politikën e Jashtme

Mungojnë:

Arben Ahmetaj - Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Përshëndetje!

Sot në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve do të shqyrtojmë miratimin e projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 30 shtator – 18 tetor 2019, pasi ka mbaruar afati 3-javor dhe ka ardhur momenti për të miratuar kalendarin e ri.

Besoj se të gjithë jeni njohur me draftkalendarin në rrugë elektronike. Ai përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancat plenare, kështu që seancat plenare për këtë 3-javor do të jenë përkatësisht në datën 30 shtator, që i bie ditën e hënë, ora 17:00, datat 3, 10 dhe 17 tetor, të cilat janë si zakonisht ditëve të enjte në orën 10:00.

Ju përmenda datën 30 shtator, ditën e hënë, pasi dua të sjell në vëmendjen e gjithë anëtarëve të Konferencës së Kryetarëve se me ndryshimet e Rregullores së Kuvendit do të jetë 1 javë në muaj, dita e hënë, java që u dedikohet zgjedhësve, ku deputetët nuk do të kenë seancë plenare në javën e fundit të muajit, por do të kenë veprimtari me zgjedhësit e tyre për t'i njohur ata me punimet e Kuvendit, si dhe me trajtimin e problemeve që ata kanë në qarqe apo në zonat zgjedhore.

Pra, në datën 30 shtator, ditën e hënë, Kuvendi do të zhvillojë seancë plenare për problematikat e evidentuara nga zgjedhësit në bazë të Rregullores së Kuvendit, neni 40/1. Seanca do të jetë jo më e gjatë se 4 orë dhe koha do të ndahet në mënyrë të barabartë pozitë-opozitë, duke përfshirë të gjithë deputetët, jo vetëm ata të grupeve parlamentare, por edhe deputetët që nuk janë në grupe parlamentare. Para seancës të njoftohen deputetët. E para.

E dyta, para seancës të rakordohet nëpërmjet drejtorisë së seancave me kryetarët e grupeve për të dhënë diskutantët sipas kohës dhe në qoftë se koha nuk mjafton, diskutantët që nuk do ta marrin fjalën do ta marrin atë në seancën tjetër të radhës.

Lidhur me projektligjet që i paraqiten Kuvendit do të doja të tërhiqja vëmendjen dhe kujdesin e ministres për Marrëdhëniet me Parlamentin, veçanërisht lidhur me relacionet shoqëruese të projektligjeve, të cilat duhet të respektojnë rigorozisht kërkesat e nenit 68, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, pasi në shumë raste ka mjaft projektligje që vijnë në Kuvend jo sipas kërkesave të përcaktuara nga Rregullorja dhe këtu kam parasysh, në radhë të parë, pjesën e konsultimit me publikun.

Pra, tabela e konsultimit me publikun në shumicën e rasteve mungon në të gjitha relacionet e projektligjeve megjithëse është e detyrueshme për një kategori jo të vogël projektligjesh.

Diçka tjetër, përsëri për këtë, është se mungon raporti i vlerësimit të ndikimit, që është i detyrueshëm, sipas Rregullores së Këshillit të Ministrave. Pra, janë vënë re mospërputhje të tekstit të relacionit me projektligjin; mangësi në shpjegimin e disa risive që sjell projektligji e që në relacion nuk përmendet fare; mangësi në shpjegimin e efekteve sociale dhe ekonomike që ka ai projektligj për një komunitet të caktuar për efektet mjedisore e të tjera, për të mos përmendur këtu edhe mangësitë në tekstet e marrëveshjeve ku tabela e përputhshmërisë, apo anekse dhe shtojca të tyre mungojnë.

E dyta, përsëri për marrëveshjet. Është detyrim ligjor që marrëveshjet në Kuvend nuk duhet të vijnë të pavërtetuara zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë.

Problem tjetër jo më pak i rëndësishëm ngelet tabela e përputhshmërisë me legjislacionin e Bashkimit European, pasi në shumicën e rasteve ka mjaft pasaktësira, në disa raste nuk jepen arsyet e plota të përputhshmërisë, të plota apo të pjesshme, dhe në disa raste nuk jepen afatet për arritjen e përafritit të plotë, gjë që është e detyrueshme, sipas Rregullores, ose ka pasur raste kur nuk është identifikuar qartë shkalla e përputhshmërisë. Është shënuar, fjala vjen në tabelën përkatëse përputhshmëria e plotë, ndërkohë që ka rezultuar që përputhshmëria nuk është e plotë, por e pjesshme. Pothuajse në të gjitha rastet referenca e instrumentit ligjor të legjislacionit të Bashkimit European, e cila bëhet nëpërmjet shënimit në fund të faqes dhe që lidhet me titullin e projektligjit, nuk jepet e saktë aq sa detyron komisioni përkatës, që në rastin konkret është Komisioni i Integritit, ta saktësojë dhe për pasojë të votohet më pas në seancë plenare. Ka pasur raste kur projektligji, megjithëse synon përputhshmëri me legjislacionin e Bashkimit European nuk është konsultuar siç duhet me Ministrinë përgjegjëse të Integritit, prandaj do të kërkoja më shumë impenjime në hartimin e relacioneve shoqëruese të projektligjit dhe në të gjithë dokumentacionin që e shoqëron atë.

Këto kisha si sugjerime për qeverinë.

Tani do të kalojmë te projektkalendari.

Kush ka mendime?

Po, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari- Zoti Kryetar, meqenëse kemi një seancë dëgjimore në Komisionin e Integrimit me ministrin e Jashtëm, zotin Cakaj, na duhet të largohemi, kështu që po vijoj duke u ndalur në një çështje.

Meqenëse na ndan vetëm një muaj nga vendimi i Këshillit European për çeljen e negociatave për Shqipërinë, si Komisioni i Integrimit kemi menduar për të propozuar një projektrezolutë, me propozimin e anëtarëve, por edhe në mbikëqyrjen e kryetares dhe nënkryetares së Komisionit të Integrimit. Jemi duke rënë dakord për tekstin, por do të kisha dëshirë që projektrezoluta të futet në kalendar dhe ta diskutojmë në seancë në javët në vijim për të ngritur këtë çështje shumë të rëndësishme dhe për të inkurajuar Bashkimin European dhe vendet anëtare për çeljen e negociatave dhe institucionet tona për një bashkëpunim sa më të mirë në mënyrë që të vijojmë dhe zbatojmë të gjitha rekomandimet e Bashkimit European. Kjo projektrezolutë vjen falë vullnetit të gjitha palëve, meqë interesi ynë për hapjen e negociatave është përtej partiak.

Kështu që uroj ta vëmë në javët në vijim këtë projektrezolutë në axhendë, meqë kemi vetëm një muaj që na ndan nga hapja e negociatave.

Gramoz Ruçi – Zoti Balla.

Taulant Balla- Qoftë Komisioni i Integrimit European, qoftë Këshilli Kombëtar për Integrimin janë dy institucionet, të cilat Kuvendi i Shqipërisë i ka ngarkuar me detyrën e rëndësishme të bashkëveprimit të të gjitha forcave politike në dobi të aspiratës historike për integrim europian. Diskutimi që është zhvilluar në Byro dhe në Komisionin e Integrimit është në dobi të procesit. Kujtoj këtu që procesi është në fazat e fundit. Një sërë parlamentarësh të vendeve anëtare e kanë shqyrtuar, javën e ardhshme Gjermania do ta shqyrtojë dhe do të marrë një vendim lidhur me këtë çështje. Këshilli European i 17-18 tetorit do të vendosë. Drafti është i mirë. Në aspektin gjuhësor duhet punuar për të qenë një dokument serioz dhe që adreson çështjet që lidhen me fillimin e bisedimeve.

Fillimi i bisedimeve është një moment historik. Pa dyshim që menjëherë më pas, sipas procedurës së përcaktuar nga Komisioni European, do të jetë komiteti ndërministror mes Shqipërisë dhe Komisionit European, i cili do të hartojë axhendën për përcaktimin e kapitujve. Unë jam tërësisht dakord që në seancën e parë të tetorit, sipas asaj që kemi në Konferencën e Kryetarëve, për të respektuar edhe atë që kemi vendosur të gjithë në Rregulloren e re, ta kalojmë me konsensus të plotë, do të ishte mirë, me qëllim që të japim një mesazh domethënës

për faktorin e huaj, pra parlamentet e vendeve anëtare dhe Këshillin, se kur është fjala për integrimin shqiptar, ne bëhemi bashkë.

Gramoz Ruçi – Plotësisht dakord. Të rakordohet në komisionin përkatës që të vihet në draft, pastaj të vihet në dispozicion të grupeve parlamentare dhe menjëherë pastaj, pasi të jetë gati, ta përfshijmë në javën e parë të tetorit, më 3 tetor.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Në kalendarin trejavor të punimeve të Kuvendit në seancën e datës 17 tetor janë parashikuar dy projektligje të rëndësishme që në kalendar kanë numrin 12 dhe 13, lidhur me mediet audiovizive dhe komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi, por meqenëse ky ligj po diskutohet gjerësisht me OSBE-në pa dyshim do të merret në konsideratë opinioni i OSBE-së, kështu që në vlerësimin tim si një nga relatorët në komision, data 17 nuk është realiste. Nuk ka filluar ende shqyrtimi, nuk ka ardhur opinioni i zyrës së OSBE-së në Vjenë, do të thotë se do të ishte më mirë t'i japim kohën, aq më tepër që këto dy projektligje kanë sensibilitet shumë të madh brenda dhe jashtë vendit.

Gramoz Ruçi – Po, zoti Manja.

Ulsi Manja- Bashkohem me atë që u tha këtu nga zonja Hajdari dhe kolegu Balla, për të pasur një rezolutë në mbështetje të procesit të integritit të fazës së çeljes së negociatave. që ne presim me Bashkimin Europian.

Kam dy shqetësime në lidhje me projektligjet që do të që vijnë nga qeveria dhe relacionet që e bashkëshoqërojnë projektligjin. Ju, me të drejtë, i kishit listuar disa mangësi që kanë këto relacione që bashkëshoqërojnë projektligjet, por, e shikoj të udhës, meqenëse këtu kemi edhe ministren e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, të them se në këto relacioneve shpeshherë nuk janë pasqyruar tryezat e konsultimit publik, që janë zhvilluar në funksion të këtyre projektligjeve që kalojnë në qeveri. Ne, në Komisionin e Ligjeve e kemi shumë të nevojshme dhe të domosdoshme që në relacion të pasqyrohen tryezat e konsultimit publik për efekt të transparencës parlamentare. Ka shumë aktorë dhe faktorë që i mbikëqyrin punimet e Komisionit të Ligjeve, që shpeshherë na kanë kërkuar organizimin e tryezave të konsultimit publik për projektligjet. Në fakt, që nga ministritë e linjës, kur projektohet inicimi i këtyre projektligjeve, ka konsultime publike për të gjitha projektligjet, por ato duhet të pasqyrohen në relacion. Përveç mangësive të tjera që ka projektligji, nuk janë pasqyruar edhe tryezat e konsultimit publik.

Së dyti, duke qenë se Rregullorja e re ka përcaktuar afate të reja për njoftimin e seancës plenare, por edhe për përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve të projektligjeve në Kuvend, unë do të kërkoja nga shërbimet e Kuvendit, por edhe nga Konferenca e Kryetarëve që t'i respektojmë këto afate, në mënyrë që të mos kemi ngjeshje të rendit të ditës në seancë plenare. Një rend dite i mbingarkuar nuk duhet të jetë patjetër qëllim në vetvete. Pra, ne duhet të kemi kohën e nevojshme në dispozicion që të respektojmë afatet që dikton Rregullorja. Këtë ne mund ta bëjmë bashkërisht në Konferencën e Kryetarëve. Pra, rendi i ditës i seancës plenare nuk duhet të jetë qëllim në vetvete, për shembull, që seanca e datës 3 tetor të ketë 11 çështje, por të marrim kohën e duhur, në mënyrë që për projektligjet që kemi në dorë, sidomos në Komisionin e Ligjeve, të respektojmë afatet e reja.

Sa për shqetësimin që ngriti zonja Hysi lidhur me futjen në kalendar të projektligjit “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” në datën 17 tetor të vitit 2019, është e vërtetë që ky projektligj bashkë me një tjetër projektligj, i cili ka të bëjë me shërbimet medietike *online* dhe me projektligjin për AKEP-in, janë në formën e një pakete që po diskutohen edhe me OSBE-në në Vjenë. Ne mund ta fusim në kalendar datën 17 për këtë projektligj, por, nëse brenda këtij afati nuk do të ketë ardhur ende materiali që ne po diskutojmë me OSBE-në në Vjenë, atëherë, sigurisht ne mund ta ndryshojmë këtë datë. Gjithsesi, ne jemi të detyruar ta presim këtë bashkëpunim me OSBE-në.

Gramoz Ruçi – Kush tjetër e do fjalën?

Adriatik Alimadhi - Faleminderit!

Në fakt, në pikën 6 të kalendarit të punimeve të seancës plenare të datës 03.10.2019 është shënuar projektligji “Për ndryshimet e statusit të veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”. Unë do të kërkoja mirëkuptimin tuaj dhe të pjesëmarrësve, duke qenë se është edhe 75-vjetori i Çlirimit të vendit, në mënyrë që kjo çështje të mos behej pjesë e debatit publik, për të mos i mbajtur shqiptarët të përçarë dhe ky projektligj të shtyhet deri në përfundimin e afatit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Pa dyshim, projektligji “Për ndryshimet e statusit të veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare” bazohet në ligjin e miratuar në vitin 1994, pra ka 25 vjet, ku shumica në Kuvendin e Shqipërisë përbëhej nga deputetë të PD-së. Edhe asokohe, unë këtë e kam verifikuar, ky ligj ka kaluar me konsensus publik, sepse vlerësimin për Luftën Antifashiste

Nacionalçlirimtare nuk na takonte ta bënim ne, sepse e ka bërë historia. Modifikimet e sjella në ligj thjesht dhe vetëm e përafrojnë atë me të njëjtën qasje, që kanë të gjitha vendet europiane lidhur me Luftën Antifashiste kudo në Europë.

Në këtë kontekst, përkundrazi, unë mendoj se është një detyrim i Kuvendit të Shqipërisë që edhe në kuadër 75-vjetorit, si kudo në Europë edhe në Shqipëri, të kemi një qasje dhe përfaqje të legjislacionit rregullues për vlerësimin e këtij momenti historik.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare mbetet një prej plejadave më të rëndësishme të historisë sonë, e cila e ka radhitur Shqipërinë përkrah vendeve fituese antifashiste të Luftës së Dytë Botërore, qoftë me SHBA-të, qoftë me Britaninë e Madhe, qoftë me Francën. Historia ka treguar që ne sot të jemi pjesë e Aleancës strategjike të Atlantikut të Veriut. Prandaj, duke e mirëkuptuar edhe zotin Alimadhi, ky nuk është aspak politizim i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por është vlerësim korrekt. Nëse do të futemi në diskutimin e ligjit, nuk është vendi këtu në Konferencën e Kryetarëve për ta diskutuar, besoj se edhe ju do të ishit dakord me rregullimin që synohet të bëhet.

Faleminderit!

Adriatik Alimadhi – Në fakt, dua ta bëj më të qartë idenë time. Unë e di që ju keni fituar dhe ne jemi poshtëruar, por problemi qëndron këtu: duke parë që në mediet shqiptare transmetohen përballjet midis palëve politike, unë mendoj se në këtë mënyrë ne përçajmë shqiptarët. Ideja ime është: a ka mundësi ta kalojmë këtë çështje në mënyrë pak më teknike, që t'i vëllazërojmë shqiptarët? Në qoftë se ju thoni që unë duhet të vij me detyrim, ju mbajeni këtë ide, por unë nuk vij te ju, sepse kam tjetër qasje. Pra, unë po them që duhet t'i mbajmë shqiptarët të bashkuar dhe të vëllazëruar. Kjo është ideja ime, por, në qoftë se ju thoni: do ta bëjmë medoemos sepse është e lavdishme, në fakt, kullon gjak shqiptari. Ju bëjeni, por problemi qëndron, a ka mundësi që shqiptarët edhe mbas 30 vjetëve, t'i afrojmë, pastaj t'ia lëmë me gjakftohtësi kohës që të eliminojë gjërat e tjera. Kjo më bën mirë politikisht nëse ju doni ta trajtoni, por shqiptarët po i përçani.

Dakord, ju vazhdojeni, sepse keni fituar, por keni fituar padrejtësisht. Por po ju them ta bëni këtë në të mirë të njëri-tjetrit, nëse e doni, pastaj ju votat i keni dhe mund të vendosni vetë.

Unë them, a ka mundësi ta spostojmë. A i lexoni gazetat? “Ky është armik”, “ky është bashkëpunëtor”, ku do shkojmë kështu? E thashë edhe në seancën që kaloi se është shumë prekëse. A prekeni ju ndopak? Ju keni fituar, sepse keni vrarë, por, ju lutem, shikojeni pak.

Ku do të shkojmë kështu zotërinj? Mirë ne që po ju mirëkuptojmë, po ata që e kanë

nivelin pak më ndryshe? Teknikisht kalojeni, por nuk e di se sa do të ishte e dobishme, por vlerësoj që edhe për statusin që ne kemi, do të ishte mirë ta kalojmë pak në heshtje. Ju vazhdoni dhe bëjeni, por unë them se ne shqiptarët po i mbajmë të përçarë, në “tradhtarë”, “bashkëpunëtorë” dhe “e lavdishme”.

Po t’i futesh historisë, ju nuk e keni lexuar, por çfarë thotë historia tani, janë fakte. Ju nuk i dini, se askush nuk i ka lexuar ato. Ju thoni: “e lavdishme”, sepse ashtu i keni mbajtur edhe njerëzit, statistikat i keni, sepse keni gjithë administratën, edhe këtu po na poshtëroni. Por edhe kur thua një mendim tjetër, mos e interpretoni ndryshe. Unë po them se ne shqiptarët po i mbajmë të përçarë. A ju shërben interesi i pajtimit kombëtar? Ky është misioni që kemi, pastaj janë të tjerat.

Ju kërkoj ndjesë, zoti Kryetar!

Gramoz Ruçi – Po, zoti Murrizi!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dua të shtoj diçka jashtë rendit të ditës, por, meqë u hap një debat, që i përket seancës, për statusin e veteranit, me sa di unë, e kemi nesër në komision, shikoj se nuk ka ndonjë gjë shtesë nga ajo që është artikulluar. Dikush e ka quajtur arritje, ndërsa dikush disfatë ligjin e vitit 1994. Aty caktohet vetëm data, mesa di unë, 20 korriku si dita e veteranëve, ushtarit të luftës. Shpjegimet në detaje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me thënë të drejtën, duke pritur negociatat për të hyrë në BE, konceptet dhe pikëpamjet për luftën gjithsecili i ka sipas asaj që mendon, unë nuk besoj se jemi renditur për hatër të luftës me amerikanët, sepse, po të na kishin dashur aq fort, Taulant, nuk do të na kishin lënë në kooperativë për 50-vjet.

Nuk di se sa partizanë jetojnë tani, sepse partizani më i ri duhet të jetë i datëlindjes 1928, pra tani duhet të jetë 91 vjeç, ndërsa më i vjetri nuk e di se sa duhet të ketë qenë. Unë u kam bërë një kërkesë zyrtare sigurimeve shoqërore dhe atyre që nxjerrin listën e votuesve, për të parë se sa shqiptarë janë 91, 92 dhe 93 vjeç.

Unë shikoj me shall pionieri ata që kanë lindur mbas prishjes së kooperativave dhe thonë se kemi qenë në luftë. Kjo është tallje. Ndërsa pikëpamjet për luftën gjithsecili e shikon sipas asaj që mendon. Sa herë afrohen fushatat, do t’i bëjnë lavde dhe rreshtojnë elektoratin e tyre. Na hapët barkun.

Ju kam pyetur publikisht në Kuvend, nëse më jepni një përgjigje zyrtare se sa vetë janë varrë dhe sa kanë varrë trimat tanë, unë do të dorëzoj mandatin në mes foltores së Kuvendit. Nuk numërohen varrezat akoma.

Jeni tallur me këtë popull 50 vjet dhe vazhdoni me propagandë. Pardje, më 16 shtator në Konferencën e Pezës pashë se kishte edhe me shall pionieri.

Unë nuk besoj se janë nostalgjikët që ju kanë sjellë në pushtet. Jo, jo, ishte arroganca e atyre që ishin 8 vjet në qeveri. Po të mos kishin atë harbutllik që mbanin nga katër parfume në zyra, nuk kishit ardhur në pushtet. Ishte arroganca e këtyre që dalin në rrugë, që vijnë vërdallë Kryeministrisë, sepse duan ta marrin përsëri. Nuk vinit në pushtet ju me 91-93-vjeçarët. Na e bëtë bajat këtë punë. Në fakt, nuk doja të flisja për këtë temë.

Zoti Kryetar, dua të them dy gjëra, meqenëse është edhe ministrja që mbulon marrëdhëniet me Kuvendin.

Në cilësinë e deputetit, në bazë të ligjit nr. 8550, të Rregullores së Kuvendit dhe Kushtetutës, u jam drejtuar me kërkesë zyrtare disa ministrive për të marrë informacion. Shikoj se iu duket vetja sikur kanë hipur në anije kozmike, kështu ka qenë edhe kampioni, po i qaset burgut, dreqi avash, avash.

T'i thoni Olta Xhaçkës dhe Sandër Lleshaj, se Sandri ka qenë shef shtabi në kohën e Fatmir Mediu, nuk ju ka sjellë nëna atje, por edhe disa agjencive qendrore që bëjnë miliona euro tendera të fshehtë. Këtë nuk dua ta bëj debat në parlament, sepse duket sikur po fitoj kapital politik, por mua nuk më shkon mendja fare për asnjërin nga ata. Ata duhet të zbatojnë ligjin, sepse ua kam kërkuar si deputet. Edhe një qytetar ka të drejtë të marrë informacion, kur nuk është konspirativ. Si deputet, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ duhet të më japin informacion për atë që u kam kërkuar. Pra më avash, zbrisni në tokë, sepse ka parë shumë kjo botë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kanë kaluar të gjitha afatet, sepse ua kam dërguar që në 10-12 korrik. Për dy apo për tri javë ata kanë të drejtë të më kthejnë përgjigje.

Zoti Kryetar, dua të flas jashtë rendit të ditës, nuk e di nëse është në tagrin e Konferencës së Kryetarëve, a të bëjmë ndonjë vendim, a të biem dakord të gjithë parimisht, për 15 apo 20 deputetët e rinj, të cilët kanë nevojë të mbështeten. Më duket se deri në vitin 2009 ka qenë ligji që deputetët dhe funksionarët e lartë publik përfitonin një kredi me interes të ulët. A ekziston mundësia që të bëhet një vendim Kuvendi apo qeverie, nëse keni ndrojtje

nga populizmi thoni që e ka propozuar Myslim Murrizi, që këta deputetë të marrin kredi? Ata nuk janë aksionerë as në PPP-të dhe as në tendera, por e kanë të nevojshme të mbështeten me një kredi, siç kam marrë unë, por edhe ju në vitin 1997, 1992 dhe në vitet e tjera me radhë. Nuk besoj se është hipokrizi për të ndihmuar 15 apo 20 deputetë, prandaj duhet ta bëjmë një vendim. Pra, bëhet fjalë për 1 miliard lekë të vjetër, që janë më pak se 1 milion euro. T’ia heqim Unazës 100 metra dhe t’ua japim këtyre deputetëve që të kenë edhe ata një farë dinjiteti, sepse po bëhen si arixinjtë me çadra. Unë besoj se gjithsecili deputet që është futur tani ka një farë rëndësie për mbarëvajtjen e këtij vendi, edhe për ekzistencën në këmbë të këtij parlamenti, ishalla po na hapen negociatat. Pra, nuk na kushton asgjë t’i mbështesim për të blerë një shtëpi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kush dëshiron të flasë?

Enver Roshi – Zoti Kryetar, a mundem?

Kam për të thënë diçka për rendin e ditës. Në datën 10 janë planifikuar dy projektligje për Komisionin e Shëndetësisë. Ne do të donim ta shtynim një javë më vonë projektligjin për pajisjet mjekësore, pasi nuk jemi gati për të dyja ligjet në datën 10. Projektligjin për pajisjet mjekësore të shtyjme për mbledhjen e datës 17.

Gramoz Ruçi – Të shikohet!

Ermonela, vazhdoni!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Kam diçka për kolegun Murrizi.

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin “Për statusin e veteranit”” ka qenë i përfshirë edhe në programin dhe kalendarin e mëparshëm, thjesht nuk ishte caktuar një datë e shqyrtimit të tij në Kuvendin e Shqipërisë. Ishte reflektuar si punë në komision. Ka vetëm një ndryshim dhe për këtë shkak ne kemi gjykuar ta bëjmë mbledhjen ditën e nesërme.

Për sa u takon shqetësimeve të tjera që ju keni, natyrisht, unë nuk dua të bëj asnjë lloj replike me ju, por besoj se nuk na takon ne, politikanëve, ta bëjmë historinë. Historinë e bëjnë historianët, por as nuk mund të themi që gjermanët, fashistët dhe nazistët ikën vetë nga Shqipëria dhe se shqiptarët nuk luftuan. Natyrisht, kush pati ndjenjën e atdhedashurisë, luftoi dhe njerëzit kanë dhënë jetën për vendin. Ne na takon t’i respektojmë.

Projekti që sjellim vendos një datë për krijimin e organizatës së veteranëve, si një datë për nderimin e veteranëve nga i gjithë vendi. Këtë kisha për të thënë.

Pra, nuk ka asnjë shkelje procedurale. Arsyeja pse bëhet tani është se ne jemi në prag të 75-vjetorit të çlirimit të atdheut, që besoj se do ta festojnë të gjithë.

Gramoz Ruçi – Kush e dëshiron të flasë tjetër?

Vazhdoni.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Dy propozimet që bën kolegët Hysi dhe Manja le t'i gjejmë së bashku këtu. Normalisht, nëse duhet shtyrë, ta shtyjmë, por edhe nëse presim atë datë, nuk ka asnjë problem. Jemi dakord ta bëjmë me konsensus dhe nuk kanë asnjë shqetësim.

E dyta, e përsëritet dhe e vlerësoj propozimin e nënkryetarit, zotit Murrizi, për kërkesën që bëri për deputetët.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kush dëshiron tjetër të flasë?

Unë do të them dy-tri gjëra.

Ju lutem, këtu jemi në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve dhe debatet politike, që janë jashtë sallës, të mos i sjellim këtu!

Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithëve, sepse sa herë që flasim për këtë luftë, duket sikur është bërë midis dy palëve në Shqipëri, partizanëve dhe ballistëve. Pra, e ngarkojmë veten më shumë se ç'duhet. Kjo luftë ka qenë kundër pushtuesve dhe pushtues nuk ka qenë asnjë shqiptar. Pushtues kanë qenë gjermanët. Të mos e shndërrojmë pjesën e luftës në pjesë të arenës së luftës politike brenda vetes. Ky është një sugjerim modest.

Ne si Kuvend duhet t'i ndjekim informacionet për deputetët. Ka një Rregullore, një ligj për deputetin, si bëhet kërkesa, kush e adreson, kur kërkohet, ku adresohet dhe kur përgjigjet. Nëse nuk përgjigjet, është detyra e Shërbimeve të Kuvendit të ndjekin kërkimin e informacionit. Pra, në të gjitha rastet nuk duhet të ketë asnjë informacion të kërkuar nga kushdo deputet, i cili të mos jetë plotësuar nga cilitdo institucion. Kjo nuk është fakultative, por është një detyrim ligjor, është një marrëdhënie midis institucioneve dhe, në fund të fundit, nuk është e domosdoshme vetëm transparenca e cilitdo institucioni qoftë, por përveç rolit ligjvënës, Kuvendi ka edhe rolin monitorues dhe kontrollues, individualisht si deputet, si komision apo si institucion, ndaj nuk duhet të ketë asnjë spekulim në këtë drejtim.

Lidhur me kërkesën e deputetëve për kredi, ju lutem, kanë ardhur deputetë që e kanë shqetësim, e kanë pasur edhe të tjerët. Ka qenë dikur, është hequr. Të jemi realist, është e

vështirë që ne të bëjmë një ligj tani, por mund të shikohet problemi dhe do të kërkoja mirëkuptimin tuaj, që nëpërmjet Bashkisë së Tiranës, që ka fondin e kredive të buta, të interesohemi të përcillet shqetësimi që kemi ne. Por të bëjmë ne tani një ligj, se janë 5, 10 apo 20 deputetë, për më tepër për specifikën që kemi, që në mes të mandatit një pjesë e deputetëve kanë djegur mandatet, një pjesë e deputetëve kanë ardhur, që janë për një periudhë 1-vjeçare, e të tjera, nuk besoj se do të dalim gjëkund si Kuvend, me mbështetje në këtë drejtim.

Për ligjet që u propozuan këtu, komisionet të vazhdojnë punën sipas Rregullores. Nëse nuk arrihet, fjala vjen, nuk vjen mendimi i OSBE-së, është normale që duhet të shtyhet. Sikurse edhe dy-tri kërkesa që ishin për të kaluar nga një datë në një tjetër, të kihen në konsideratë!

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA